



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijemeno / Predato Received / Delivered	25.09.2023	3	viti god vegr
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSTJK 6241/2023			112



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1155/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1155/2023, të datës 12.09.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike „shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.09.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1155/2023, të datës 19.09.2023, të parashtruar nga ankuesja

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

A r s y e t i m

Ankuesja (me tej referuar vetëm ankuesja), me datën 09.09.2023 përmes Postës së Kosovës, ka parashtruar ankesën me numër protokollit 6059/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 12.09.2023, me pretendimet ankimore që t'i njihet e drejta e harmonizimit të koeficientit të pagës sikurse kolegëve të saj në pozitat *Kuzhinier*, të Qendrave Burimore në Kosovë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja në bazë të Kontratës së punës, me numër protokollit 311048-161, të datës 02.08.2016, mbanë pozitën e punës “*Kuzhinier*” në kuadër të Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “*Nëna Tereze*”, në Mitrovicë.

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 2 të këtij ligji, është përcaktuar se: “...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. *nëpunësi i Shërbimit Civil* (në tekstin në vijim: *nëpunësi civil*); 2.2. *nëpunësi i Shërbimit Publik*; 2.3. *nëpunësi i Kabinetit*; dhe 2.4. *nëpunësi administrativ dhe mbështetës*.... 3. *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën*



në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, ....6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike...” rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në Kontratën e Punës se ankueses me numër protokollit 311048-161, të datës 02.08.2016, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita “Kuzhinire” hynë në kategorinë e nëpunësve administrativ-teknik dhe mbështetës, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1155/2023 të datës 12.09.2023 të parashtruar nga ankuesja.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që lënda të dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duke u bazuar në nenin 24 paragrafin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson faktin se nëpunësit **administrativo-teknik dhe mbështetës**, fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1155/2023

Ardita Ferçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Komisionit për Ankesa në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

